

**MARENGLLEN VERLI****NJË EKSPOZE E SHKURTËR RRETH KONTRIBUTIT  
TË INSTITUTIT TË HISTORISË – TIRANË, PËR HISTORINË  
E KOSOVËS NË VITET 1981-2007\***

Titulli i kësaj kumtese mund të kishte qenë edhe “Kontributi i Institutit të Historisë - Tiranë për historinë dhe çështjen e Kosovës”, sepse veprimtaria e këtij instituti i ka pasur të gërshetuara fort këto elemente, sepse ajo ka qenë sa studimore, aq edhe me vlera praktike në pasqyrimin dhe mbështetjen e zhvillimeve politike aktuale në Kosovë, pjesë e zhvillimeve tona kombëtare. Do të duhet ta cek këtë temë në aspektet kryesore të punës sonë gjatë dekadave të fundit.

**1. Së pari, duhen përmendur përpjekjet për të futur sadopak tema të historisë së Kosovës në studimet dhe botimet tona dokumentare deri në vitin 1981.** Gjatë kësaj periudhe në artikuj të ndryshëm, kryesisht të botuara në revistën “Studime historike” dhe në ndonjë botim monografik e dokumentar, u dha një informacion i gjerë kryesisht për periudhën historike para vitit 1912<sup>1</sup>.

\* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore të organizuar nga Instituti i Historisë-Prishtinë me rastin e 50-vjetorit të themelimit të tij.

<sup>1</sup> Niko Koleci, *Kryengritja e Përgjithshme shqiptare kundër sundimit turk në vitin 1912*, Tiranë, 1962; *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)*, vëll. I, II, Tiranë: 1979, 1980; Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek.XV-XX)*, Tiranë: 1973; Zija Shkodra, “Problemi i tregut shqiptar në shek. XVIII”, në revistën *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1966; Zija Shkodra, “Çështje të tregut shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare”, në revistën *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1978; Ligor Mile, “Rreth lëvizjes kryengritëse shqiptare në çerekun e dytë të shek.XIX e sidomos rreth kryengritjes së Kosovës së vitit 1844”, në revistën *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1966; si dhe artikuj të profesor Aleks Budës, që trajtojnë etnogjenezën e shqiptarëve, probleme të shteteve mesjetare arbërore, Rilindjen Kombëtare Shqiptare, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit etj.; artikuj të Kristo Frashërit, Gazmend Shpuzës e Kristaq Priftit, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, të Burhan Çirakut për Bajram Currin, të Selami Pulahës për Betejën e Fushë-Kosovës 1389, mbi gjendjen demografike e ekonomike të viseve të Kosovës, për Rilindjen Kombëtare e Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, të Petrika Thëngjillit për Betejën e Fushë Kosovës, 1389, etj.

Në këtë kuadër, në revistën “Studime historike” u botua edhe ndonjë artikull i studiuesve nga Kosova e Maqedonia<sup>2</sup>, si edhe u prezantuan referate e kumtesa në veprimtari të ndryshme shkencore. Ndër këto referime duhen përmendur ato që u mbajtën në konferencat e mëdha ndërkombëtare me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit të Skënderbeut (1967) dhe veçanërisht me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1978), mandej në ndonjë konferencë si ajo e organizuar me rastin e 50-vjetorit të vrasjes së Shtjefën Gjeçovit etj.<sup>3</sup>

Po në këtë periudhë, domethënë deri në vitin 1981, në revistën “Studime historike” u publikuan gjithashtu njoftime dhe rezultate të disa ekspeditave etnografike e arkeologjike të organizuara në Kosovë nga arkeologë e etnografë të njohur të Institutit të Historisë, i cili përfshinte aso kohe edhe këto fusha studimi<sup>4</sup>.

Por, kujdesi në nivelet më të larta shtetërore për të mos acaruar marrëdhëniet me Jugosllavinë, jo vetëm në varësi të situatës politike të Shqipërisë, madje, fillimisht, për shkak të lidhjeve Shqipëri - Kinë dhe qëndrimeve të Kinës ndaj Jugosllavisë, por edhe për të mos shtuar pengesat e elitës politike dhe intelektuale të Kosovës për të përparuar, të drejtat politike të Krahinës (sidomos pas vitit 1974 kur u sigurua Kushtetuta), ndikuan që, për periudhën pas vitit 1912, të mos kishte projekte studimore e aq më pak publikime e botime. Pas vitit 1978, domethënë pas prishjes së marrëdhënieve midis Tiranës dhe Pekinit, faktori ky që përcaktoi inercinë e pasivitetit edhe për disa vjet, ishte varësia e madhe e ekonomisë së rrënuar të Shqipërisë nga tregtia me klering që bëhej me RF të Jugosllavisë (gati 70% e tregtisë së jashtme). Kjo i diktoi udhëheqjes së PPSH dhe të shtetit shqiptar pozicionin që në

<sup>2</sup> Mark Krasniqi, “Disa burime pak të njohura mbi popullsinë e Kosovës”, në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1979; Aleksandër Matkovski, “Kryengritjet në Sanxhakun e Ohrit në vitet 1566-1574”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1973; Zef Mirdita, “Mbi prejardhjen e dardanëve”, në *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1973; Muhamet Tërnavë, “Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shek. XV-XVI”, në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1979, etj.

<sup>3</sup> Shih *Studime historike*, nr.1, Tiranë: 1967; *po aty*, nr. 1, Tiranë: 1968; *po aty*, nr.1, Tiranë: 1978; *po aty*, nr.3-4, Tiranë: 1979.

<sup>4</sup> Shih *Studime historike*, nr.2, Tiranë: 1972; *po aty*, nr. 2, Tiranë, 1974; *po aty*, nr.1, Tiranë: 1979; Ekspedita të drejtuara nga Abaz Dojaka, Spiro Shkurti, Mark Tirtja e Dhimitër Budina.

fushën e albanologjisë të ndalonte kategorikisht dhe të censuronte publikimin e shkrimeve për historinë e Kosovës.

**2. Studimi i mirëfilltë i historisë së Kosovës për periudhën pas vitit 1912 do të intensifikohej në vitet 80-të.** Në pritje të situatave të vështira ekonomike e politike për Shqipërinë pas prishjes së marrëdhënieve me RP të Kinës, kur internacionalizmi nuk kishte më vlerë për t'u propaganduar në popull, qarqet drejtuese të PPSH ndërmorën gradualisht një kthesë që orientonte drejt shfrytëzimit, si motiv mobilizimi, nacionalizmin, apo ideologjinë kombëtare, me tematikë historike edhe nga trojet shqiptare përtej kufijve të Shqipërisë. Ajo që kishte filluar me promovimin e historisë së Skënderbeut me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së tij më 1968, si dhe historisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare të shek. XIX, duke shfrytëzuar vitin jubilar të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, do të çohet më tej me krijimin e një sektori të posaçëm në Institutin e Historisë, të destinuar posaçërisht për studimin e Historisë së Kosovës për periudhën pas vitit 1912.

Gjithsesi, ky sektor me 5 studiues (L. Nasi, M. Verli, A. Lalaj, Z. Shtylla i drejtuar fillimisht nga doc. Burhan Çiraku e nga viti 1981 nga prof. dr. Kristaq Prifti), që fillimisht do të punonte sikur të ishte një krijesë ilegale, do të forcohej vit pas viti. Çdo anëtar i tij do të formohej e ngrihej profesionalisht, do të hulumtonte e grumbullonte dokumente e materiale, do të hartonte studime e monografi, madje do të zhvillonte edhe një cikël special leksionesh me mësues dhe studentë të degës së historisë në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës<sup>5</sup>. Produktet e para të sektorit të Kosovës ishin artikuj studimorë, që filluan të botohen në revistën "Studime historike", në median e shkruar dhe disa studime të veçanta, që ishin të destinuara për t'u servirur njohuri

---

<sup>5</sup> Lefter Nasi mori përsipër studimin e situatës në Kosovë në vitet e Luftës së Dytë Botërore, Marenglen Verli, studimin e proceseve të shpronësimit agrar të shqiptarëve në vitet 1912-1941, Ana Lalaj, problemet që lidheshin me statusin e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, kurse Zamir Shtylla, problemin e shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve nga Kosova e Jugosllavia gjatë shekullit XX.

historike strukturave partiake e shtetërore, që kërkonin informacion të saktë për historinë e shqiptarëve në Jugosllavi pas vitit 1912<sup>6</sup>.

Ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë treguan se krijimi i Sektorit të Kosovës më 1979 kishte dalë një investim i mirë për shkencën dhe kulturën shqiptare. Pas vitit 1981, inteligjencia kosovare u vu nën kudhër, përmes “diferencimit” e lloj-lloj presionesh, dhe ishte në kushte të papërshtatshme për studime. Ndër të parët e pësoi edhe prof. Ali Hadri “babai i historianëve shqiptarë në Jugosllavi”, apo “vëllaçkoja”, si e quanin kolegët e tij në Shqipëri (kontakti i parë nga afër me profesorin e nderuar, për fat të keq edhe i fundit, ishte në sesionin shkencor kushtuar 55-vjetorit të Bajram Currit, organizuar në qytetin me të njëjtin emër në maj të vitit 1980). Situata e sipërpërmendur e vështirësoi prodhimin e pacensuruar të historianëve shqiptarë në Kosovë. Në këto rrethana, Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë hapi dyert e revistës “Studime Historike” për të ribotuar artikuj të thukët të historianëve kosovarë, të publikuara gjatë viteve ’60 -’70<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Lefter Nasi, “Masat për rikolonizimin e Kosovës në vitet 1945-1947”, në revistën *Studime historike*, nr.2, Tiranë: 1990; L. Nasi, “Mbi statusin politik të Kosovës gjatë dhe në fund të Luftës së Dytë Botërore”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1991; Marenglen Verli, “Gjendja e arsimit në Kosovë në vitet 1940-1941”, në revistën *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1990; M.Verli, “Përpyqjet serbo-malazeze për kolonizimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në vitet 1913-1915”, në revistën *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1983; M.Verli, “Pikëpamjet e përfaqësuesve të borgjezisë serbe rreth reformës agrare kolonizuese në trevat shqiptare (1913-1941)”, në revistën *Studime historike*, nr.3, Tiranë: 1989; M.Verli, “Shpronësimi rrënjësor i fshatarësisë shqiptare në Jugosllavi në vitin 1938”, në revistën *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1991; Ana Lalaj, “Evoluimi i statusit të KSA të Kosovës në amendamentet kushtetuese të viteve 1968-1969”, në revistën *Studime historike*, nr.4, Tiranë: 1990; A.Lalaj, “Ndryshime të reja në statusin kushtetues juridik të KSA të Kosovës (1971-1972)”, në revistën *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1991; Zamir Shtylla, “Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936-1941”, në revistën *Studime historike*, nr.3, Tiranë: 1990; Z.Shtylla, “Rreth krijimit e veprimtarisë së Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në vitet 1918-1920”, në revistën *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1986, Kristaq Prifti, Z.Shtylla, “Komiteti “MKK” dhe veprimtaria e tij për çlirimin dhe unitetin kombëtar”, në revistën *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1988 etj. U botuan edhe shumë shkrime divulgative në medien e shkruar.

<sup>7</sup> *Bibliografi e revistës “Studime historike” (1964-2014)*, përgatiti për botim Majlinda Ahmeti-Rapaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2017; Ali

Ndërkohë, studiuesit e profilizuar të Sektorit të Kosovës i kishin shtuar botimet. Brenda disa vjetësh, përveç artikujve shkencorë e divulgativë, referateve e kumtesave në disa veprimtari apo sesione shkencore (sesioni shkencor në Fushë-Krujë 1981, kushtuar Shote Galicës, sesioni shkencor në Tiranë në vitin 1984 i organizuar për trajtimin e problemeve të historisë së Kosovës, ai më 1988 për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” etj.)<sup>8</sup>, ishin realizuar 4 doktoratura (atëherë hartoheshin disertacione për të mbrojtur gradën “Kandidat i Shkencave”) me një vëllim 300-400 faqe secila. Ato trajtonin temën e shpronësimit agrar të shqiptarëve në Jugosllavi, midis dy Luftërave Botërore, kolonizimin e Kosovës etj., me elementë sllavë, temën e shpërnguljeve të shqiptarëve nga trevat e tyre, rezistencën shqiptare, trajtonin gjithashtu situatën dhe qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë në vitet e Luftës së Dytë Botërore, si edhe evoluimin e statusit të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore etj. Porsa përfundoi realizimi i këtyre disertacioneve, filloi përgatitja e temave të dyta, përkatësisht për shfrytëzimin specifik të ekonomisë së Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, për spiralen e dhunës që filloi të shkallëzohej në Kosovë pas vitit 1981 etj.<sup>9</sup>

Situata politike dhe ekonomike në Shqipëri e në rajon nuk bëri të mundur gjatë viteve '80 botimin e këtyre temave, por kur këto panë dritën dhe u publikuan si monografi gjatë viteve '90, impakti qe shumë pozitiv, qoftë në Shqipëri, qoftë në emigracionin shqiptar e kosovar, apo në diasporë e, për aq sa depërtuan, edhe në Kosovë, por edhe ndër studiuesit e huaj, që jo vetëm i cituan, por edhe u shprehën me vlerësime

---

Hadri, “Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)”, në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1988; Flamur Hadri, “Historiografia shqiptare mbi burimet dokumentare dhe letrare të epokës së Skënderbeut”, në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1986; Zef Mirdita, “Rëndësia e materialit epigrafik në ndriçimin e strukturave etnike e politike në Dardani në kohën romake”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1981; Jahja Drançolli, “Diaspora shqiptare në Greqi gjatë shek. XIV”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1987; Jahja Drançolli, “Lidhjet e bujarëve raguzianë me Durrësin gjatë shekullit XIII-XIV”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1986, etj.

<sup>8</sup> Informacion nga arkivi personal i autorit.

<sup>9</sup> Po aty. Shih edhe protokollat e mbledhjes në sektorët për vitet 1986-1987.

të larta për disa prej tyre (Noel Malcolm, Michel Ru, Miranda Vickers, Michael Schmidt Nekke etj.)<sup>10</sup>

Sot e kësaj dite këto botime hyjnë në produktin e zgjedhur të historiografisë shqiptare. Në shërbim të mbështetjes së politikës kombëtare me argumente shkencore, pas rritjes së represionit në Kosovë në vitet 1988-1989, në një kohë rekord u përgatit një vëllim me studime e dokumente të zgjedhura që atakonte historiografinë e politikën serbe për të gjitha periudhat historike. Përveç studiuesve të Sektorit të Historisë, për këtë vëllim kontribuuan të gjithë studiuesit e Institutit të Historisë, që kishin filluar t'i qaseshin ndërkohë gjithnjë e më shumë temës së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, madje u përfshinë në vëllim edhe artikuj të personaliteteve të shquara të albanologjisë që nga prof. A. Stipçeviq deri te Milan Shuflaj etj.

Vëllimi u përgatit edhe në dy gjuhë të huaja, në anglisht e në shqip dhe do të botohej në shqip më 1990 dhe në anglisht më 1992, me titull "E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi"<sup>11</sup>. Për fat të keq, botimi në frëngjisht nuk u realizua kurrë.

**3) Vijimi intensiv i studimit të historisë së Kosovës e më gjerë në vitet '90 dhe intensifikimi i botimeve.** Pikërisht në këtë periudhë, gjatë viteve 1992-2000, u botuan monografite e shkruara në vitet '80 (M. Verli, "Reforma agrare, kolonizuese në Kosovë 1918-1941", 1992; L.Nasi "Ripushtimi i Kosovës 1944-1945", 1994; M. Verli, "Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970-1980", 1984; L. Nasi "Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë (1981-1986)", 1994; M. Verli "Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave", 2000; A. Lalaj, "Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes", 2000) dhe pati nisma për përgatitjen dhe botimin edhe të veprave dokumentare e memoaristike. Dolën kështu njëri pas tjetrit vëllime me kujtime për historinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Plavë e Guci, për Lëvizjen Kombëtare në Kosovë gjatë dekadave të fundit të sundimit osman e më pas, që kishin Isa Boletinin si protagonist, për angazhimin e elitës

<sup>10</sup> Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha, 1998 (shih Bibliografinë e botimit dhe shënimet në referencat e tij); Michael Roux, *Les albanais en Jugoslavie*, Paris 1992 (shih Bibliografinë); Miranda Vickers, *Shqiptarët*, Tiranë, 2008 (shih Parathënien, etj.).

<sup>11</sup> *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 1990; *The truth on Kosovo*, Tiranë: 1992.

politike kosovare të vendosur në Shqipëri gjatë vitit 1918 etj. (përgatitur nga M. Verli)<sup>12</sup>. Në disa vëllime me studime, që u publikuan gjatë viteve '90 në Kosovë, por më tepër në diasporë, artikujt e studiuesve të Institutit të Historisë në Tiranë do të zinin vend prestigjioz. Në shërbim të elitës politike të Kosovës, që përpiquej të sensibilizonte botën dhe të realizonte aspiratën e popullit për një Republikë të pavarur të Kosovës, Institutet respektive në Tiranë dhe Prishtinë filluan në vitin 1994 botimin e revistës “Kosova”, që dilte në dy gjuhë, anglisht dhe shqip, e destinuar kryesisht për publikun e huaj dhe diasporën shqiptare, gjithashtu organizuan një konferencë të madhe, të veçantë për problemet e Kosovës (1994), finalizuar më 1996 me botimin e akteve në dy vëllime në shqip dhe në anglisht, me titull “Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual”<sup>13</sup>.

4) **Sensibilizimi i kombit për betejën e madhe të çlirimit.** Vitet 1998-1999 bartën ngjarje të mëdha për Kosovën. Nën drejtimin e UÇK-së, populli shqiptar i Kosovës u përfshi në një ballafaqim vendimtar me okupatorët serbë për të ardhmen e vet. Nuk mund të qëndronin jashtë kësaj rrjedhe historianët e Institutit të Historisë. Vështirë të bëhet një bilanc sot i atij aktivizimi me artikuj në medie, veçanërisht në gazetën “Rilindja”, që kishte filluar prej disa vitesh të botohej në Tiranë, fillimisht me redaksinë e instaluar diku pas Teatrit të Estradës e më pas në një rrugë të njohur me emrin “Myslym Shyri”. Mund të them se personalisht botova aty dhjetëra artikuj, që shpesh nuk ishin divulgativë, por artikuj studimorë, që u ishin hequr vetëm referencat<sup>14</sup>. Gjatë atyre dy viteve të stuhishëm mora pjesë edhe në shumë emisione televizive dhe në mbi 100 emisione radiofonike, kryesisht në kanalin që transmetonte për bashkatdhetarët të drejtuar nga gazetarja e pasionuar Elmira Muja\*. Gati çdo tri ditë i takonte të realizohej një transmetim. Kolegët e tjerë të

<sup>12</sup> Elmaz Pllana, *Plava e Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: 1994; Tafil Boletini, *Kujtime, Pranë Isa Boletinit, Përballë sfidave të kohës*, Tiranë: 1995.

<sup>13</sup> *Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual*, Tiranë: 1996.

<sup>14</sup> Një pjesë e këtyre artikujve janë përfshirë në vëllimin Marenglen Verli, *101 Profile Biografike (Nga Kosova për Kosovën)*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kritalina, 2017.

\* Disa kaseta me materiale të incizuara, që u transmetuan aso kohe, i ruaj ende në fonotekën personale.

sektorit gjithashtu u aktivizuan në shumë emisione të ndryshme televizive e radiofonike. Kjo veprimtari ishte padyshim një mbështetje e rëndësishme morale për popullsinë dhe luftëtarët kosovarë.

**5) Përfshirja e historisë së Kosovës në vepra madhore, të botuara në dekadën e parë të shekullit tonë është një kontribut tjetër i Institutit të Historisë, Tiranë.** Me insistim të veçantë të Departamentit të Historisë së Kosovës, në Projektin e madh “Historia e Popullit Shqiptar”, që u botua në katër vëllime në vitet 2002-2008, u përfshi për herë të parë për periudhën pas vitit 1912, historia e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Instituti i Historisë kishte sjellë edhe më parë kontribut në vepra kolektive: më 1999 ishte botuar nga Akademia e Shkencave vëllimi “Kosova në vështrim enciklopedik”, por këtu dimensionin ishte tjetër. Në vëll. III dhe VI, që trajtonin historinë e shek. XX, pas vitit 1912, historia e Kosovës, Çamërisë dhe diasporës, për herë të parë qenë të pranishme me rreth 300 faqe, që përbënte mbi 25% të materialit të këtyre dy vëllimeve<sup>15</sup>. U ndërмор edhe një hap më tej: Bashkautorë, në pjesët respektive, u përfshinë edhe autorë nga Kosova. Tani kjo ishte e mundur pa probleme, jo vetëm për shkak të teknikës së re (kompjuterit dhe internetit) të futur masivisht në përdorim, por edhe për shkak të lehtësisë në realizimin e takimeve të rregullta të studiuesve të institucioneve shkencore analoge në Tiranë e Prishtinë. Nëse në vitet '80-'90 takimet ishin të rralla dhe të kujtojnë herë-herë ato që ndodhin në rrethana ilegaliteti, që nga viti 1999, kur pushteti serb në Kosovë mori fund, lidhjet erdhën duke u shtuar. Prof. Fehmi Rexhepi, pas tij Jusuf Bajraktari në detyrën e drejtorit të Institutit të Historisë, Prishtinë, treguan vlera në bashkërendimin e punëve.

Fryma me të cilën u projektua e zbatua hartimi i “Historisë së Popullit Shqiptar”, dominoi dhe në projektin për ribotimin në 3 vëllime të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar<sup>16</sup>. Me një bashkëpunim të vazhdueshëm, ku ndër shumë emra të nderuar nga Kosova, do të veçoja të ndjerin prof. Muhamet Piraku, u seleksionuan në disa faza zërat me

<sup>15</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, *Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007; *po aty*, vëll.IV, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, 1939-1940*, Tiranë: Toena, 2009.

<sup>16</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, vëll.I, Tiranë: Kristalina K-H, 2008; *po aty*, vëll.III, Tiranë: Kristalina K-H, 2009.

temë nga historia e kësaj treve (për personalitete dhe ngjarje historike të Kosovës), të cilat, në fazën përfundimtare, për periudhën historike pas vitit 1912 ishin rreth 300, përkatësisht  $\frac{1}{4}$  e të gjithë zërave.

#### **6) Projekte e botime të përbashkëta me kontribut të ndërsjellë.**

Ajo që mbetet të thuhet më tej është se bashkëpunimi, në këtë rast edhe kontributi i Institutit të Historisë së Tiranës për historinë e Kosovës, ka njohur vetëm rritje. Përveç botimeve madhore të sipërpërmendura duhen përmendur shumë konferenca e simpoziume e deri tryeza shkencore, që ishte e pamundur të evidentoheshin në këtë kumtesë me tematikë shumë të larmishme. Ato kanë qenë për ngjarje të mëdha që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, nga veprimtaria e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, për përvjetore të Pavarësisë së Shqipërisë, për ngjarje të periudhës para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, për kryengritje e rezistencë me çeta në Drenicë në vitet 1919-1924, për kryengritjen e vitit 1945 të njohur edhe si kryengritja e Shaban Polluzhës, për demonstratat e viteve 1968, 1981 etj., për personalite si H. Prishtina, B. Curri, A. Galica dhe Sh. Galica, I. Seferi etj., etj. Shumica e këtyre veprimtarive kanë sjellë një kontribut të shtuar, duke u finalizuar me botime e nisma projektesh për botime të përbashkëta dokumentare etj.<sup>17</sup>

Gjatë viteve 2005-2007 u startua me sukses edhe në drejtim të botimeve të përbashkëta. Gjatë këtyre viteve, duke qenë në detyrën e drejtorit të Institutit të Historisë-Tiranë, pata kënaqësinë të nënshkruaj me prof. dr. Jusuf Bajraktarin, drejtor i Institutit të Historisë-Prishtinë, një marrëveshje-kuadër, që, e rinovuar, nga akademik Beqir Meta dhe prof. asoc. dr. Sabit Sylja, ka vijuar dhe është në veprim sot e kësaj dite, si edhe disa marrëveshje konkrete.<sup>18</sup> Bibliotekat e arkivat i kemi pasur të

<sup>17</sup> Shih për këto veprimtari dokumentacionin e Institutit të Historisë të viteve 1999-2017. Shumë ftesa e programe të veprimtarive të sipërpërmendura ruhen edhe në arkivin personal të autorit.

<sup>18</sup> Marrëveshja për bashkëpunim midis Institutit të Historisë-Tiranë, dt. 30.6.2006 nr. prot. 10, me Institutin e Historisë-Prishtinë, nr. prot. 50, firmosur nga prof. dr. Marenglen Verli dhe prof. dr. Jusuf Bajraktari. Marrëveshje bashkëpunimi për botimin e një vëllimi me dokumente midis Institutit të Historisë-Tiranë dhe Institutit të Historisë-Prishtinë, 30 qershor 2006, firmosur nga drejtuesit respektivë të dy instituteve; Projekti i veprimtarive me Kosovën për vitin 2007, firmosur në Tiranë 19.06.2007, që përfshinte katër konferenca e simpoziume si edhe takime për bashkërendimin e punëve për vitet 2007-2008, më 27 gusht 2007 në Tiranë

hapura reciprokisht dhe për shkak se studiuesit në Tiranë kanë pasur fatin të jetojnë prej 105-vjetësh në një shtet shqiptar të pavarur, u është dhënë mundësia të vënë në dispozicion të kolegëve nga Prishtina, një pasuri dokumentare të konsiderueshme të krijuar e përpunuar për shfrytëzim profesional gjatë shumë dekadave.

Nga kjo hapje e këto marrëveshje, edhe falë vullnetit e angazhimit të madh për punë të shumë studiuesve rezultatet janë të konsiderueshme. Do të veçoja për rezultatet në këtë drejtim profesorin e nderuar Muhamet Shatri, që finalizoi në kuadër të bashkëpunimit të sipërpërmendur botimin e vëllimeve me dokumente franceze dhe angleze<sup>19</sup>. Punë edhe më të mëdha vijuan pas 2007 e na presin edhe në të ardhmen.

Në vitet '80 filloi puna për një vëllim me dokumente, lidhur me veprimtarinë e UNÇL-së përtej kufirit të shtetit shqiptar, por kjo në fillim të viteve '90 u ndërpre, për shkak të ndërrimit të regjimit politik në Shqipëri. Nëse puna do të ishte finalizuar sot do të kishim një material të mirëfilltë autentik dokumentar për të gjykuar një periudhë historike me probleme të diskutueshme.

Në vitet 1994-1996 dhe pas vitit 2007, sektori/departamenti i Kosovës u suprimua dy herë: herën e parë për arsye voluntariste, i vlerësuar si i panevojshëm nga drejtues të Institutit të Historisë, me pretekstin se historinë e Kosovës e bëjnë tani vetë studiuesit kosovarë, kurse herën e dytë për arsye se Instituti i Historisë u reduktua numerikisht në mënyrë drastike. Ndërkohë, njëri nga studiuesit, që startuan në sektorin e Historisë së Kosovës në vitin 1979, kishte ndërprerë punën e mirëfilltë shkencore në vitin 1992, sepse kishte kaluar në detyra administrative (në Akademinë e Shkencave). Në vitin 1997 edhe dy të tjerë filluan punë në detyra administrative, duke pasur pak kohë të lirë për veprimtari të drejtpërdrejtë hulumtuese e botuese.

Që të vijojë puna në mënyrën e duhur, pa improvizime e angazhime tangenciale do të duhet të rifillojë një punë perspektive me rekrutim rishtas të studiuesve të rinj, të cilët duhet të dinë, ose duhet të orientohen për të mësuar veç të tjerash, gjuhën serbe e maqedonase etj. Pesha që

---

dhe 5 shtator 2007 në Prishtinë, gjithashtu kërkime reciproke në arkiva e bibliotekat e të dy instituteve etj.

<sup>19</sup> Muhamet Shatri, *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Tiranë: Toena, 2012; Muhamet Shatri, *Dokumente britanike për çështjen shqiptare*, Tiranë: Toena, 2012.

---

mbajnë sot M. Verli, A. Lalaj e H. Kaba nuk garanton perspektivën e studimeve të mirëfillta në Tiranë për historinë e Kosovës.

Duke përfunduar, ndihem i obliguar të bëj një homazh për kolegët në Tiranë e Prishtinë me të cilët kam punuar që nga viti 1981 e që sot nuk i kemi midis nesh. Dhe dua të kujtoj me respekt maksimal ata, që pavarësisht nga mosha, vijuan të punojnë deri ditën e fundit të jetës. Prof. Kristaq Prifti, pas vëllimit “Popullsia e Kosovës 1831-1912”, që pa dyshim është një vepër madhore, nuk u ndal për të përgatitur librin e radhës që tashmë ka shkuar në shtyp.

Përfundoj duke besuar se bashkëpunimi i mëtejshëm është e ardhmja që duam, i cili sjell rezultatet që presim.

